


Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2017

Tiranë, Maj 29, 2019: Në vitin 2017, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korente u vlerësua 1.551.281 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 3,82 %, krahasuar me vitin 2016.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2017, e ka dhënë Qarku Tiranë me +3,42 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Durrës me + 0,40 pikë përqindje dhe Qarku Fier me +0,18 pikë përqindje. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Vlorë me -0,19 pikë përqindje, i pasuar nga Qarku Korçë me një kontribut prej -0,13 pikë përqindje dhe Qarku Lezhë me një kontribut prej -0,03 pikë përqindje.

Fig.1 Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike



Për publikim 29/05/2019

Sipas rajoneve statistikore në nivel 3, rritjen më të lartë e shënoi Qarku Tiranë me një rritje në terma realë prej 8,54 %, i ndjekur nga Qarku Durrës me një rritje në terma realë prej 4,09 % dhe Qarku Berat me një rritje në terma realë prej 1,92 %.

Rritja ekonomike u ngadalësua në Qarkun Vlorë, duke shënuar një rënie në terma realë prej 3,26 % dhe në Qarkun Korçë me një rënie në terma realë prej 2,22 %.

Tab. 1 PBB sipas rajoneve statistikore

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB çmime korente (million Lekë)	PBB çmime korente (million Lekë)	Rritja Reale e PBB-së	Kontributi ndaj rritjes Reale	Struktura ndaj PBB-së	Struktura ndaj PBB-së
		2016*	2017**	2017**/2016*	2017**/2016*	2016*	2017*
AL	Republika e Shqipërisë	1.472.479	1.551.281	3,82	3,82	100,0	100,0
AL01	Veri	350.156	361.089	1,72	0,41	23,8	23,3
AL011	Dibër	48.940	49.885	1,92	0,06	3,3	3,2
AL012	Durrës	144.605	153.886	4,09	0,40	9,8	9,9
AL013	Kukës	25.475	25.643	-0,29	-0,01	1,7	1,7
AL014	Lezhë	51.183	51.312	-0,77	-0,03	3,5	3,3
AL015	Shkodër	79.953	80.364	-0,46	-0,02	5,4	5,2
AL02	Qendër	693.770	758.134	7,36	3,47	47,1	48,9
AL021	Elbasan	104.100	106.061	0,70	0,05	7,1	6,8
AL022	Tiranë	589.670	652.072	8,54	3,42	40,0	42,0
AL03	Jug	428.554	432.058	-0,19	-0,06	29,1	27,9
AL031	Berat	56.964	58.523	1,42	0,06	3,9	3,8
AL032	Fier	163.484	166.933	1,60	0,18	11,1	10,8
AL033	Gjirokastrë	34.469	35.304	1,45	0,03	2,3	2,3
AL034	Korçë	86.429	85.451	-2,22	-0,13	5,9	5,5
AL035	Vlorë	87.207	85.847	-3,26	-0,19	5,9	5,5

* 2016 Të dhëna Finale

**2017 Të dhëna gjysmë-finale


PBB për frymë sipas niveleve statistikore

Në vitin 2017, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 arriti në 540 mijë Lekë. Krahasuar me vitin 2016, PBB për frymë u rrit me 5,45 %.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3, në vitin 2017, ishte në Qarkun Tiranë, me 747 mijë Lekë dhe shënoi një rritje prej 8,0 %, krahasuar me vitin 2016. PBB për frymë e këtij qarku ishte 38,3 % mbi mesataren e vendit. Më pas renditet Qarku Fier, me 556 mijë Lekë, duke shënuar një rritje prej 3,3 %, ndaj vitit 2016. PBB për frymë e këtij qarku ishte 3,0 % mbi mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore, në nivel 3, në vitin 2017, u vlerësua në Qarkun Kukës me rreth 327 mijë Lekë, duke shënuar një rritje me 3,2 %, krahasuar me vitin 2016. PBB për frymë e këtij qarku ishte 39,5 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon Qarku Elbasan me rreth 377 mijë Lekë, duke shënuar një rritje me 3,5 % ndaj vitit 2016. PBB për frymë e këtij qarku ishte 30,1 % nën mesataren e vendit.

Fig.2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2017 (000/Lekë)



Tab. 3 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (Lekë)		Indeksi ndaj PBB-së (%)	
		2016*	2017**	AI=100	AI=100
AL	Republika e Shqipërisë	511.972	539.866	100,0	100,0
AL01	Veri	422.412	438.561	82,5	81,2
AL011	Dibër	384.393	404.654	75,1	75,0
AL012	Durrës	511.849	535.767	100,0	99,2
AL013	Kukës	316.750	326.756	61,9	60,5
AL014	Lezhë	394.816	401.157	77,1	74,3
AL015	Shkodër	382.464	389.247	74,7	72,1
AL02	Qendër	609.433	656.755	119,0	121,7
AL021	Elbasan	364.351	377.195	71,2	69,9
AL022	Tiranë	691.556	746.780	135,1	138,3
AL03	Jug	471.579	482.345	92,1	89,3
AL031	Berat	426.089	451.265	83,2	83,6
AL032	Fier	538.116	555.840	105,1	103,0
AL033	Gjirokastër	514.626	547.816	100,5	101,5
AL034	Korçë	400.373	402.597	78,2	74,6
AL035	Vlorë	462.850	454.123	90,4	84,1

* 2016 Të dhëna Finale

** 2017 Të dhëna gjysmë-finale

Standardi i Fuqisë Blerëse

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard - PPS) në vitin 2017 është 26.234 PPS, ndërsa në vitin 2016 ishte 24.883 PPS. Krahasuar me vitin 2016, Produkti i Brendshëm Bruto i shprehur në PPS shënoi një rritje prej 5,64 %.

PBB për frymë në PPS për vitin 2017 për Republikën e Shqipërisë është 30,4 % e mesatares së Bashkimit Evropian BE28 = 100 (shih shënime metodologjike). Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2017 ishte 37,0 %, në rajonin Veri 24,7 % dhe në rajonin Jug 27,2 %.

Tab.4 PBB për frymë në PPS (BE28=100)

Kodi	Rajonet Statistikore	PBB për frymë në PPS (BE28=100) në 2017	
		2016	2017
	Republika e Shqipërisë	29,4	30,4
	Rajone Statistikore Nivel 2		
AL01	Veri	24,3	24,7
AL02	Qendër	35,1	37,0
AL03	Jug	27,1	27,2

Tab. 5 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Dega = 100%), viti 2017**

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
AL	Republika e Shqipërisë	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
AL01	Veri	28,5	30,6	22,7	22,1	11,6	16,3	24,5	12,7	21,5	14,6	23,3
AL011	Dibër	5,8	6,8	1,3	1,3	1,4	1,8	1,5	0,5	3,4	0,6	3,2
AL012	Durrës	7,3	14,0	11,1	13,5	4,7	5,6	13,8	8,3	6,3	7,7	9,9
AL013	Kukës	3,0	1,8	0,9	0,7	1,2	1,3	1,0	0,5	2,5	0,8	1,7
AL014	Lezhë	4,8	2,0	4,9	2,8	1,5	3,5	3,1	1,1	3,6	2,2	3,3
AL015	Shkodër	7,6	6,0	4,6	3,8	2,8	4,1	5,1	2,4	5,7	3,2	5,2
AL02	Qendër	19,9	43,7	54,4	56,4	72,9	59,8	53,2	77,8	55,2	69,7	48,9
L021	Elbasan	12,3	8,5	4,5	4,6	3,4	4,9	5,5	1,8	6,8	3,4	6,8
AL022	Tiranë	7,7	35,2	49,9	51,8	69,5	54,9	47,7	76,0	48,4	66,2	42,0
AL03	Jug	51,6	25,8	22,9	21,5	15,5	23,9	22,3	9,5	23,3	15,7	27,9
AL031	Berat	8,5	3,4	3,0	2,0	1,8	1,9	1,9	0,9	3,4	1,6	3,8
AL032	Fier	22,4	13,2	7,4	6,9	6,0	7,9	7,0	4,1	6,4	3,1	10,8
AL033	Gjirokastrë	3,0	1,4	2,6	2,3	1,7	3,0	1,6	0,9	2,7	2,4	2,3
AL034	Korçë	10,5	3,3	4,0	4,6	2,6	5,4	4,4	1,3	5,5	5,2	5,5
AL035	Vlorë	7,1	4,5	5,8	5,7	3,4	5,6	7,4	2,4	5,4	3,4	5,5

**2017 Të dhëna gjysmë-finale


Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Tab. 6 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Rajoni = 100%), viti 2017**

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
AL	Republika e Shqipërisë	21,8	12,8	10,5	18,4	3,5	2,9	6,4	7,2	13,4	3,0	100
AL01	Veri	26,6	16,9	10,2	17,5	1,8	2,0	6,8	3,9	12,4	1,9	100
AL011	Dibër	39,1	27,1	4,2	7,4	1,5	1,6	3,1	1,1	14,3	0,6	100
AL012	Durrës	16,0	18,1	11,7	25,1	1,7	1,6	8,9	6,0	8,5	2,4	100
AL013	Kukës	39,8	14,1	5,5	7,6	2,5	2,3	4,0	2,2	20,4	1,6	100
AL014	Lezhë	31,8	7,7	15,5	15,4	1,6	3,0	6,1	2,4	14,5	2,0	100
AL015	Shkodër	31,8	14,9	9,3	13,6	1,9	2,3	6,3	3,3	14,6	1,9	100
AL02	Qendër	8,9	11,5	11,7	21,3	5,3	3,5	7,0	11,4	15,1	4,3	100
AL021	Elbasan	39,0	15,9	6,9	12,4	1,8	2,0	5,2	1,9	13,3	1,5	100
AL022	Tiranë	4,0	10,7	12,5	22,7	5,8	3,7	7,3	13,0	15,4	4,8	100
AL03	Jug	40,3	11,9	8,6	14,2	2,0	2,4	5,1	2,5	11,2	1,7	100
AL031	Berat	49,1	11,5	8,4	9,7	1,7	1,5	3,2	1,6	12,0	1,3	100
AL032	Fier	45,4	15,7	7,2	11,9	2,0	2,1	4,2	2,7	7,9	0,9	100
AL033	Gjirokastër	28,4	8,0	12,0	18,9	2,6	3,8	4,6	2,7	16,0	3,2	100
AL034	Korçë	41,6	7,7	7,7	15,4	1,7	2,8	5,1	1,7	13,4	2,9	100
AL035	Vlorë	28,1	10,3	11,0	18,9	2,2	2,9	8,6	3,1	13,1	1,9	100


**2017 Të dhëna gjysmë-finale

Fig.2 PBB për frymë sipas Qarqeve



□ NUTS 2
□ Qark

PBB për frymë në mijë Lekë




Shqipëria 540

* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore nivel 2 dhe 12 rajone statistikore nivel 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KMM nr.1037 datë 15.12.2010, "Mbi implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.


Fig. 3 PBB me çmime korente sipas Qarqeve



NUTS 2

Qark

PBB në miliardë Lekë



* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore nivel 2 dhe 12 rajone statistikore nivel 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 datë 15.12.2010, "Mbi implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.

Shënime Metodologjike

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2017 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev 2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli 13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 29 Mars 2019, në mënyre që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Informacioni më i detajuar rreth Llogarive Kombëtare Rajonale (2012-2017) mbi treguesit rajonalë mund ta gjeni në linkun më poshtë.

<http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-rajonale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: “Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri” në adresën e mëposhtme: http://www.instat.gov.al/media/251599/manual_metodologjik.pdf

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.

Standarti i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS) është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE28=100).

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme: <http://ec.europa.eu/eurostat/web/purchasing-power-parities/data/database>